



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 4822 – 221/C1049
14 Nr. 660/25
Dt. 30.06.2025

KONTRATË SHËRBIMI
(Konsulencë në fushën e kulturës)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. **Shpresa Rama Kajtazi**, me fsh. Shupkovc/ K. Mitrovicë, me nr. Personal: **1173173900**, si **Kontraktorë Individual**, në tekstin e mëtejshëm : **KONSULENTI INDIVIDUAL**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

Blerja e shërbimeve të konsulencës individuale për nevoja të Komunës së Vushtrrisë,

Lot. 1 - Shërbime kontraktuale në fushën e kulturës, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	48	2	2	2	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	1	4	2	2	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime konsulente individuale në fushën e kulturës, për nevoja të Drejtorisë për Kulturë Rini e Sport , që për referencë do të kenë aktivitetet dhe përgjegjësitë e përshkruara si në dokumentacionin standard të Aneksit 1 – Termat e Referencës (ToR) pjesë e Dosjes së Tenderit me nr. Prokurimi : VU644-25-4822-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm : VU644-25-014-221, si vijon :**

- Ofron konsulencë profesionale në organizimin e aktiviteteve të Përshkrimi i përgjithshëm i punës procesin e përgatitjes, koordinimit dhe zbatimit të planit vjetor të drejtorisë së kulturës në fushën e kulturës;
- Ofron konsulencë profesionale në organizimin e aktiviteteve për mbikëqyrjen e zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të kulturës dhe manifestimeve në këtë fushë;
- Ofron konsulencë për politikën kulturore dhe zhvillimin e turizmit, duke përfshirë analiza të situatave aktuale dhe rekomandime për përmirësim;
- Ofron konsulencë profesionale që të gjitha kërkesat përgatiten dhe procedurat e kulturës që zhvillohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- Ofron konsulencë profesionale asistimin e Drejtorit në hartimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillimin e turizmit kulturor në nivel lokal;
- Ofron konsulencë profesionale për përgatitjen e raporteve për drejtorinë, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ofron shërbime kulturore dhe konsulencë profesionale në Komunën e Vushtrrisë - si dhe asistencë në distancë përmes emailit dhe platformave digjitale, sipas nevojës edhe jashtë orarit të rregullt të punës;

- Kryen edhe detyra të tjera sipas nevojës, në përputhje me rregullat në fuqi dhe kërkesat e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë. detyra të tjera të caktuara nga Menaxheri i kontratës.

1.2 Kontrata Publike hynë në fuqi nga data : 01.07.2025, ndërsa periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 36 muaj nga data e nënshkrimit, respektivisht deri më dt. 30.07.2028

1.3 Kontrata publike i referohet Kushteve të Përgjithshme të kontratës (KPK) dhe Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) ndërsa do të implementohet nga Konsulenti Individual gjithëherë në përputhje me kornizën ligjore , udhëzimet administrative dhe rregullat të cilat rregullojnë fushën dhe legjislacionin relevant në fushën e kulturës.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, bazuar në Planin për Menaxhimin e Kontratës.

2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i njësisë së shërbimeve është paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kontraktuesi – Konsulenti Individual.

3.2 Çmimi i njësisë (Shërbime konsulentë individuale në fushën e kulturës për nevoja të Drejtorisë Komunale për Kulturë Rini e Sport, për një muaj është: 700,00€.

3.3. Vlera totale indikativë e Kontratës Kornizë është: 25,200,00€ (njëzetepesmijdyqind/00 Euro).

3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

3.4 Pagesat do të bëhen : në baza mujore, në pajtim me të dhënat e konfirmuara në Raportin me shkrim nga Menaxheri i Kontratës i A.K. Shërbimet e porositura duhen përfunduar në baza ditore kohë, në mënyrë cilësore dhe sasiore, duke respektuar kushtet e kontratës, përfshirë dhe detyrat e përshkruara si në Aneksin 1 – Termat e Referencës (ToR)

3.5 Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna Vushtri.

Për Kontraktuesin :
Konsulent Individual

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Shpresa Rama Kajtazi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Konsulente në fushën e kulturës
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.06.2025	Data:	30.06.2025
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 665/25
Dt. 01.07.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe ZPP-së, më dt. **01.07.2025** merë:

V E N D I M

1. Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxheri të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Blerja e shërbimeve të konsulences individuale për nevojat e Komunës së Vushtrrisë -ri tenderim me numër të prokurimit: VU644-25-4822-2-2-1 dhe numër të brendshëm VU644-25-014-2-2-1**, si vijon :

Pet Lot 1 Ne shtepin e Kultures

z.Liridon Hajdini, emërohet menaxher i kontratës.

z.Izet Miftari, emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Planin e menaxhimit të kontratës do të krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me kushtet e Kontratës dhe Porositë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkojë mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpilojë – lëshoi një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoi Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm

- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë dhe Operatorit Ekonomik : Shpresa Rama Kajtazi

Kopje: Menaxheri i Kontratës;

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;

Drejtorisë së Prokurimit;

Drejtorit të Njesisë Kërkuuese

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi, poashtu çmimin duhet ta shkrueni me dy decimalle pas presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Numri Konsulentëve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për Njësi-€ Një Muaj	Shuma -€
1	Sherbime kontraktuale ne fushen e kultures	1	Muaj	36	700.00	25,200.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM:						25,200.00

IDENTIFIKIMI I KONSULENTIT/E INDIVIDUAL (KI)	
EMRI DHE MBIEMRI I KI:	
NËNSHKRIMI:	
DATA:	

AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRRIË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: VU644-25-4822-2-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Shpresa Rama Kajtazi, Shupkovc, 40000, Mitrovice, Kosovë

E-mail: shpresa.ramaa@gmail.com

Personi kontaktues: Shpresa Rama Kajtazi

Telefoni: +38344668956

Faxi:

Numri fiskal: 000000/00

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):